



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

### **KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANGAZHIM NË POZICIONIN E KRYETARIT TË KOMISIONIT LIGJOR PRANË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE**

Bordi i Mbikëqyrjes Publike në zbatim të kërkesave të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786 datë 09.11.2016 “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, njofton të gjithë të interesuarit të paraqesin kërkesën e tyre për Kryetar të Komisionit Ligjor të ngritur pranë BMP.

Të interesuarit duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara si më poshtë vijon:

- Të kenë përfunduar, të paktën, studimet universitare të ciklit të dytë, në nivelin “Master” ose të zotërojnë diplomë universitare të ekuivalentuar me këtë nivel, si dhe të jenë specializuar në fushën e jurisprudencës, me përvojë profesionale jo më pak se dhjetë vite, ose 7 vite përvojë pune, në rast se mbajnë një gradë apo titull shkencor;
- Të kenë së paku 2 vite eksperiencë brenda ose jashtë vendit në çështjet e lidhura me profesionin kontabël;
- Të kenë njohuri të Ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar dhe Ligjit nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Gjithashtu, duhet të:

- a) jenë shtetas shqiptarë;
- b) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata;
- c) të mos kenë konflikt interesi me anëtarët e Bordit të Mbikëqyrjes Publike apo strukturat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së komisionit;
- ç) të mos jenë të angazhuar në role apo funksione politike;
- d) të kenë marrë titullin avokat.

Personat e interesuar duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm deri në datën 22.02.2022 pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

- Letër motivimi;
- CV;
- Fotokopje e diplomës së nivelit Master;
- Reference pune nga punëdhënësi i mëparshëm.

Duke ju falenderuar!

Bordi i Mbikëqyrjes Publike